

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PKL-KZZ-01/11

Data: 05 prill 2011

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX Martti Harsia si kryetar kolegji, dhe gjyqtarët e Kosovës të Gjykatës Supreme të Kosovës Nesrin Lushta dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, në praninë e Adnan Isufit Këshilltar Ligjor i EULEX-it, duke vepruar në cilësinë e procesmbajtësit,

Në çështjen penale P Nr. 2615/08, të Gjykatës Komunale të Prishtinës kundër të pandehurit:

Sokol Quse, (e gjinisë) i lindur më , i , me i dënuar për veprën penale:

Ushtrim i ndikimit, në kundërshtim me nenin 345 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Falsifikim i dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332 paragrafi 1 në lidhje me paragrafin 3 të KPK.

Duke vendosur për Kërkesën mbi Mbrojtjen e Ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës Shemsedin Pirraj në emër të pandehurit Sokol Quse, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës P Nr. 2615/08 të datës 09 shtator 2009, dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, AP Nr. 351/10, të datës 8 shtator 2010,

Ne pajtim me nenin 454 para 1 të Kodit mbi Procedurën Penale të Kosovës (tash e tutje "KPPK"), pas seancës të këshillimit dhe votimit të mbajtur më 05 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:


AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e datës 10 tetor 2010 e paraqitur nga avokati mbrojtës Shemsedin Pirraj në emër të pandehurit Sokol Quse, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës P Nr. 2615/08 e datës 09 shtator 2009, e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës AP Nr. 351/10 e datës 8 shtator 2010 sipas nenit 456 të KPPK, **refuzohet** si e pabazuar.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Gjykata Komunale e Prishtinës me aktgjykimin e datës 9 shtator 2009, shpalli të pandehurin fajtor për veprën penale **Ushtrim i ndikimit** në shkellje të 345 paragrafi 1 i



KPK dhe **Falsifikim i dokumenteve** në shkelje të nenit 332 paragrafi 1 në lidhje me paragrafin 3 të KPK dhe i ka shqiptuar dënimin unik prej dy (2) vite burgim si edhe e ka urdhëruar të kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën prej 100 euro.

Avokati mbrojtës i të pandehurit Zivojin Jokanovic me kohë ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës P. Nr. 2615/09.

Gjykata e Qarkut në kolegjin e përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtarë vendor, me aktgjykimin e 8 shtatorit 2010 ka refuzuar ankesën e mbrojtjes si të pabazuar dhe vërtetoi tërësisht aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

Më 15 nëntor 2010, avokati mbrojtës Semsedin Piraj në emër të pandehurit Sokol Qyse paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të lartpërmendur.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës paraqiti mendimin e saj më 21 janar 2011 duke propozuar refuzimin e kërkesës si të pabazuar.


II. Çështjet e ngritura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesë avokati mbrojtës përsërit pohimet tanimë të paraqitura në ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale. Prandaj avokati përsëri pretendon:

- Se aktgjykimi është i bazuar në prova të papranueshme kur letra e shkruar me dorë (e datës 8 gusht 2007) e A Y ishte miratuar si provë.
- Se të pandehurit nuk i është dhënë mundësia për ta pyetur A Y dhe ta kundërshtoj vlerën provuese të letrës.
- Veprimi i të pandehurit nuk përmban veprën penale Ushtrim të Ndikimit pasi që i pandehuri nuk ka kontaktuar person zyrtar qoftë gjyqtar apo prokuror.
- Dokumentet e falsifikuara nuk janë lloje të dokumenteve që përcaktohen në nenin 332 para 1 të KPK pasi që këto nuk janë destinuar për të bindur A Y të ndikoj të pandehurin mbi gjyqtarin ndërkombëtar.
- Shuma 80.000 euro ishte destinuar për kredi të pandehurit, e megjithëse A Y ka pritur një ndihmë si shërbim kthyes, i pandehuri megjithatë nuk ka pasur ndikim të vërtetë në gjyqtarin ndërkombëtar apo prokurorin ndërkombëtar.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Në vlerësimin e Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi si më poshtë:



- a. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pranueshme. Kërkesa është paraqitur në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 454 par 1 dhe brenda afatit në pajtim me nenin 452 par 3 të KPPK.
- b. Gjykata Supreme e Kosovës vendosi në një seance sikurse përshkruhet në nenin 454 paragrafi 1 i KPPK. Njoftimi i palëve të kësaj seance nuk ishte i nevojshëm.
- c. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.


Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të dhënave dhe kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të avokatit mbrojtës si edhe mendimit të Prokurorit Publik të Kosovës konstatoi se aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë nuk justifikuan një intervenim *ex officio*. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës në vlerësimin e saj kufizohet me nenin 455 të KPPK në lidhje me arsyet e kërkesës dhe argumenteve të ngritura nga paraqitësi i kërkesës.

Argumenti i parë i ngritur nga i pandehuri e vë në pyetje pranueshmërinë e letrës të datës e letrës e datës 8 gusht 2007. Sikurse Gjykata e Qarkut ka konstatuar se prova do të përcaktohet si provë e papranueshme vetëm nëse ajo është marrë 'me shkelje të dispozitave të procedurës penale' dhe kur 'ligji shprehimisht e parashikon kështu'. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nuk e definon këtë lloj letrë të bashkë të-pandehurit si të papranueshme kur ky material ka qenë paraqitur në kohë gjatë shqyrtimit kryesor dhe ka qenë në dispozicion të mbrojtjes. Gjykata e Qarkut i është referuar jurisprudencës së GjNDNj. Sikurse Gjykata e Qarkut ka vënë në pah se dënimi në këtë lëndë nuk bazohet vetëm apo në masë vendimtare në deklaratën e cila nuk mund të konfrontohet nga i pandehuri.

Kolegji vëren se letra e lartë përmendur e datës 8 gusht 2007 është përmendur në të dhënat e seancës së Gjykatës Komunale më 8 shtator 2009 dhe avokati mbrojtës i Sokol Quse ka deklaruar se është në dijeni për ato dhe se ka një kopje të tyre.

Në lidhje me mundësinë e mbrojtjes për të intervistuar dhe kundërshtuar dëshminë e A Y dhe për ta pyetur Y ky kolegji mendon se prova e prezantuar gjatë gjykimin është konsideruar e mjaftueshme për të bindur gjykatën për fajësinë e Sokol Quse. Procedura kundër të pandehurit Y A është ndarë me vendim të Kryetarit të kolegjit, Arkadiusz Sedek me qëllim të shmangies të vonesës të lëndës së Sokol Quse. Në të vërtetë kjo shkon në favor të pandehurit Sokol Quse për tu marrë me lëndën e tij dhe për ta kompletuar më shpejt.

I pandehuri ka pretenduar se veprimi i tij nuk përbën vepër penale pasi që ai nuk ka kontaktuar ndonjë person zyrtar. Sikurse Gjykata e Qarkut drejt e ka interpretuar dhe zbatuar nenin 345 të KPK, vepra penale Ushtrim i Ndikimit nuk kërkon ndonjë kontakt me zyrtarin vendim marrës.



Sa i përket natyrës dhe përdorimit të dokumenteve zyrtare, kolegji pajtohet me mendimin e Gjykatës të Qarkut se dokumentet në fjalë janë lloje të dokumenteve të përcaktuara në nenin 107 par 6 të LPK. Neni 332 i LPK si kusht të domosdoshëm nuk kërkon përdorimin e dokumentit të falsifikuar. Gjykata Supreme e Kosovës është e kënaqur që Gjykata e Qarkut drejt i ka interpretuar nenet.

Sa i përket pretendimit se të hollat në shumë prej 80.000 euro ishin destinuar për kredi dhe jo shpërblim për ndërmjetësim të paligjshëm edhe pse Y... ka mundur të presë ndonjë lloj shërbimi në kthim, kolegji vëren se ky argument është i lidhur me bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike për të cilën në këtë fazë të procedurës ankesa mund të mos lejohet sipas neneve 456 dhe 451 par 2 të KPPK.

Në kuadër të kësaj që u tha më lart, pas rishqyrtimit të aktgjyqimit të kundërshtuar, kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe mendimit të Prokurorit të Shtetit, vlerësimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është se aktgjyqimet e kundërshtuara nuk kanë gabim ligjor.

Për shkak të arsyeve të lartë përmendura kërkesa e Sokol Quse duhet të refuzohet.

Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi mbi Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë si në dispozitivë bazuar në nenin 456 të KPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl-Kzz 01/11, 5 prill 2011

Kryetari i kolegjit
Martti Harsia, Gjyqtar i Eulex-it

Procesmbajtës
Adnan Isufi, Këshilltar Ligjor i Eulex-it

Anëtarët e kolegjit

Anëtare e kolegjit
Nesrin Lushta, Gjyqtare i Gjykatës Supreme

Anëtar i kolegjit
Salih Toplica, Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

